

**AKT THEMELIMI
DHE STATUTI I SHOQERISE
"EKM CONSTRUCTION" SHPK**

**KREU I
EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI**

**NENI 1
EMRI I SHOQERISE**

1.1 Sot, ne Tirane me date 07/04/2022,

Enea Murataj (themeluesi), i biri Fatos dhe Tefta, shtetas shqiptar i lindur ne Tirane me date 27.08.1993, identifikuar me Nr ID: J30827067Q, banues ne Tirane, me adrese: "Rruga Ferit Xhajko; Nd. Nr.18; Njësia Administrative Nr. 8; Njesia bashkiake Nr. 8; 1017; Tiranë; Tel: 0692026002 themelon shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emrin "EKM CONSTRUCTION" SHPK (me poshte e quajtur "Shoqeria")

**NENI 2
SELIA DHE FORMA LIGJORE E SHOQERISE**

- 2.1 Selia e shoqërisë ndodhet ne adresen: "Tirane, Autostrada Tirane-Durres, rruga dytesore km 7, Pasuria Nr 1165/25, Zona Kadastrale 2105, Kashar , kodi postar 1005
- 2.2 Ortaket mund te vendosin mbi transferimin e selise se Shoqerise ne nje adrese tjeter.
- 2.3 Personat pergjegjes per administrimin e Shoqerise mund te celin ose mbyllin dege dhe/ose zyra perfaqesimi si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise.
- 2.4 Forma ligjore e shoqerise eshte "shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" (SHPK). Megjithate, ajo mund te shnderrohet ne nje forme tjeter ne perputhje me legjislacionin tregtar shqiptar ne fuqi

**NENI 3
KOHEZGJATJA**

3.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohe me afat te pacaktuar duke vazhduar nga momenti i regjistrimit te saj ne qendren kombetare te biznesit

**NENI 4
OBJEKTI I SHOQERISE**

4.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin si me poshte:
"Veprimtari ne fushen e ndertimit, projektimit, zbatimit, ndertime civile dhe industriale, objekte banimi dhe biznesi, punime te pergjithshme ne rruge, autostratda, mbikalime, hekurudha, pista aeroportuale, porte detare etj. Hoteleri, turizem, bare restorante etj.



KREU II
KAPITALII SHOQERISE TRANSFERIMII KUOTAVE

NENI 5
KAPITALI I SHOQERISE

- 5 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 (njqindemije) leke dhe perbehet nga nje kuote/pjese qe ka vleren nominale 100,000 (njqindemije) leke.
- 6 Kapitali shoqerise zoterohet teresisht 100% nga ortaku i vetem i shoqerise Z. Enea Murataj, i cili ka kontribuar ne para gjithsej 100,000 (njqindemije) leke.
- 7 Pas regjistrimit ne QKB dhe fitimit te personalitetit juridik, shoqeria ka te drejte ta perdori kapitalin per fillimin e veprimtarise se saj.
- 8 Shoqeria mund te marre hua financiare nga ortaku saj, persona te trete fizik ose juridik, institucione bankare ne perputhje me dispozitat ligjore perkatese.
Derdhja e kapitalit do te kryhet pas regjistrimit te Shoqerise ne regjistrin tregtar, gjate fazes se zhvillimit te aktiviteti te Shoqerise.

NENI 6
TRANSFERIMI I KUOTAVE TE KAPITALIT TEK TE TRETET

- 6.1 Transferimi i kuotave te kapitalit te Shoqerise mund te behet me shitje, dhurim, trashegimi, ose me gdo menyre tjeter te parashikuar nga legjislacioni perkates ne fuqi ne R.Sh.
- 6.2 Ne rast transferimi te kuotave tek persona te trete jashte Shoqerise, qofte me shitje qofte me dhurim, ortaku qe synon te transferoje kuotat duhet t'i komunikojte ortakeve te tjere vullnetin e tij me shkrim. Ortaket e tjere kane te drejten e parablerjes te kuotave te ortakeve, me kushte te barabarta, dhe duhet ta ushtrojne kete te drejte brenda 30 diteve nga marrja e komunikimit te vullnetit te ortakut per te transferuar kuotat. Mosrespektimi i kesaj dispozite e ben te palvlefshem transferimin e kuotave.
- 6.3 Viera e kuotes qe transferohet do te percaktohet nga nje ekspert i emeruar nga ortaket me marreveshje ose nga gjykata ne rast se ortaket nuk bien dakort.

NENI 7
BARRA MBI KUOTAT E KAPITALIT

- 7.1 Kuotat e kapitalit te Shoqerise mund te rendohen lirisht me barre siguruese apo te drejta te tjera reale.

KREU III
ORTAKET E SHOQERISE, FINANCIMET

NENI 8
ORTAKET

- 8.1 Ortaket e shoqerise jane:

Enea Murataj, ortak i vetem zoterues 100% i kuotave, i biri Fatos dhe Tefta, shtetas shqiptar i lindur ne Tirane me date 27.08.1993, identifikuar me Nr ID: J30827067Q, banues ne Tirane, me adrese: "Rruga Ferit Xhajko; Nd. Nr.18; Njësia Administrative Nr. 8; Njësia bashkiake Nr. 8; 1017; Tiranë; Tel: 0692026002



NENI 10
ORGANET E SHOQERISE

Organet e shoqerise jane:

- a) **ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**
- b) **ADMINISTRATORI**

Neni 10
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

10.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimmarres i Shoqerise dhe merr vendime kur eshte mbledhur rregullisht.

10.2 Vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme, e thirrur dhe e mbledhur rregullisht, ne perputhje me ligjin dhe me kete Statut jane te detyrueshme per te gjithë ortaket perfshire ata qe mungojne.

10.3 Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne rastet e parashikuara nga ky Statut, nga ligji per shoqerite tregtare, ligje te tjera, dhe sa here eshte e nevojshme per mbrojtjen e interesave te Shoqerise.

10.4 Asambleja e Pergjithshme mbahet ne seline e Shoqerise ose ne §do vend tjeter te shenuar ne njoftimin per mbledhje. Njoftimi per mbledhje i dergohet me shkrim te gjithë ortakeve jo me vone se 7 (shtate) dite perpara dates se mbledhjes. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren dhe rendin e dites se mbledhjes.

10.5 Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret nga administratoret. Thirrja e Asamblese se Pergjithshme mund te kerkohet edhe nga ortaku ose ortaket qe perfaqesojne te pakten 5% te totalit te votave ne Asamblese e Pergjithshme.

10.6 Asambleja e Pergjithshme thirret ne sesione te zakonshme e jashtezakonshme.

Neni 11
ASAMBLEJA E ZAKONSHME

11.1 Asambleja e zakonshme mblidhet, cdo vit brenda gjashte muajve nga data e mbylljes se vitit financiar, per miratimin e raportit te administratoreve, inventareve dhe llogarive vjetore.

11.2 Vendimet merren me shumice te zakonshme te votave ne prani te ortakeve me te drejte vote qe zoterojne me shume se 50 % te kuotave.

11.3 Nese nuk arrihet kuorumi sipas pikes 11.2, Asambleja do te mblidhet perseri jo me vone se 30 dite me te njejtin rend dite. Ne rast se as ne mbledhjen e dyte nuk arrihet kuorumi, ortaket e pranishem ose rregullisht te perfaqesuar do te perbejne kuorumin.

Neni 12
ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME

12.1 Asambleja e Pergjithshme thirret ne sesione te jashtezakonshme sa here eshte e nevojshme per marrjen e vendimeve ne interes te Shoqerise.



12.2 Vendimet qe kane te bejne me (por pa u kufizuar vetem ne to): ndryshimin e neneve te Statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit, ndryshimin thelbesor te objektit te veprimtarise se Shoqerise, prishjen e Shoqerise konsiderohen vendime te jashtezakonshme.

12.3 Vendimet e jashtezakonshme merren nga Asambleja e Pergjithshme me % e votave ne prani te ortakeve qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave.

12.4 Nese nuk arrihet kuorumi sipas pikes 12.3, Asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite me te njejtin rend dite. Ne rast se ne mbledhjen e dyte nuk arrihet kuorumi, ortaket e pranishem ose rregullisht te perfaqesuar do te perbejne kuorumin.

Neni 13

Pjesemarrja, Votimi dhe Perfaqesimi

13.1 Secili ortak ka te drejten e pjesemarrjes dhe votimit ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme. Votat e disponuara nga secili ortak jane ne numer te barabarte me kuotat e zoteruara prej tij.

13.2 Secili ortak mund te perfaqesohet ne mbledhjet e Asamblese nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete me autorizim. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 14

Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme

14.1 Asambleja e Pergjithshme vendos per:

- a) percaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshimin e Statutit;
- c) emerimin dhe shkarkimin e administratorit
- d) emerimin dhe shkarkimin e likuidatori/eve dhe eksperteve kontabel te autorizuar dhe shperblimin e tyre;
- e) mbikyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimtarise;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurise se veprimtarise;
- g) miratimin e zmadhimit dhe zvogelimit te kapitalit te Shoqerise;
- h) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne procedime te tjera kunder administratorit/eve;
- j) shperndarjen e fitimeve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
- l) Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te Asamblese;
- m) Ceshtje tjetër te caktuar nga ligji ose nga ky Statut
- n) Kerkesa per kredi bankare dhe / ose nenshkrimin te faturave, garanci ose garanci ne favor te paleve te treta



NENI 15
FINANCIMI I SHOQERISE

15.1 Organi i Administrimit të Shoqerise ne perputhje me dispozitat ne fuqi pervec rasteve te zmadhimit te kapitalit ka te drejte te kerkoje nga ortaket e Shoqerise fondet e nevojshme per arritjen e objektivave te shoqerise

15.2 Financimet e metejshme te ortakeve ne shoqeri do te jene me shperblim (interesa) apo pa shperblim, ne varesi te titullit nepermjet te cilit do te levrohen keto fonde.

KREU IV
ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 16
ADMINISTRIMI I SHOQERISE

16.1 Shoqeria administrohet nga nje Administrator ;

- **Enea Murataj**, shtetas shqiptar i lindur ne Tirane me date 27.08.1993, identifikuar me Nr ID: J30827067Q, banues ne Tirane, me adrese: *“Rruga Ferit Xhajko; Nd. Nr.18; Njësia Administrative Nr. 8; Njësia bashkiake Nr. 8; 1017; Tiranë; Tel: 0692026002*

i cili emerohet nga ortaket e shoqerise per nje periudhe 5 (pese) vjecare me te drejte rizgjedhje.

Administratori shkarkohet nga detyra, ne cdo kohe, me vendim te zakonshem te Asamblese se Pergjithshme sipas Statutit te Shoqerise.

Administratori ka kompetencat dhe detyrat e meposhtme:

- a) mbikeqyr dhe zbaton politiken e biznesit te Shoqerise;
- b) perfaqeson Shoqerine;
- c) kujdeset qe Shoqeria te zbatoje ligjet dhe standartet e mbajtjes se llogarive;
- d) pergatit dhe nenshkruan bilancin dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shpemdaijen e fitimeve ja paraqet Asamblese se Pergjithshme per miratim;
- e) siguron qe deklaratat e llogarive vjetore si dhe raporti i ecurise se biznesit dhe ?do deklarim tjeter i detyrueshem sipas ligjit ose statutit, jane bere si? duhet;
- f) siguron qe auditimi i librave dhe i te dhenave kryhet te pakten nje here ne vit nga eksperte kontabel te ?ertifikuuar dhe raporti i llogaritave publike te ?ertifikuuar t'i vihet ne dispozicion Asamblese se Pergjithshme;
- g) Autorizon persona te tjere ta perfaqesojne shoqerine ne ceshtje gjyqesore, institucione dhe kudo tjeter ku eshte e nevojshme te mbrohen interesat e shoqerise.
- h) krijon nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e Shoqerise;



16.2 Administratori mund te ndermarre apo te kerkoje kryerjen e te gjitha akteve qe konsideron te nevojshme per arritjen e objektit te Shoqerise pervec atyre qe ligji apo statuti i rezervon Ortakeve apo organeve te tjera te Shoqerise.

16.3. Pervec sa me siper, Administratori ka gjithashtu

- a. te gjitha te drejtat e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem, te gjitha kompetencat dhe te drejtat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ua njej shprehimisht ortakeve.
- b. Administratori, bazuar ne nje vendim te asamblese se ortakeve, mund te emeruje drejtore, perfaqesues me prokure dhe te mandatuar te pergjithshem per veprime te caktuara ose kategori veprimesh.
- c. Administratori i shoqerise nuk mund te shese dhe/ose bleje pasuri te paluajtshme ne emer dhe per llogari te shoqerise, pa marre me pare miratimin paraprak me shkrim te asamblese se ortakeve.

NENI 17 SHPERBLIMI ADMINISTRATORIT

17.1 Shperblimi i administratorit te shoqerise do te percaktohet nga Ortaket.

KREUV KONTROLI KONTABEL I SHOQERISE VITI FINANCIAR DHE BILANCI

NENI 18 KONTROLI KONTABEL

18.1 Kontrolli i jashtem kontabel i Shoqerise kryhet nga Ekspert Kontabel te Autorizuar, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Ortaket do te emerojne nje apo me shume eksperte kontabel ne ato raste kur emerimi i tyre konsiderohet i nevojshem ose kerkohet ne baze te ligjit.

NENI 19 VITI FINANCIAR

19.1 Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti. Si perjashtim, viti i pare financiar i veprimtarise se Shoqerise fillon nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar te Qendres Kombetare te Biznesit.

NENI 20 BILANCI DHE REZERVAT

20.1 Me mbylljen e secilit vit financiar Administratoret marrin masat e nevojshme per hartimin e bilancit te aktivitetit per vitin financiar te mbyllur ne menyre qe ortaket te vendosin mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme te tij brenda afateve te percaktuara nga ligji.

20.2 Ortaket vendosin mbi ndarjen e dividendeeve qe rezultojne si fitime sipas bilancit te miratuar rregullisht, pasi nga keto shuma jane zbritur humbjet e mundshme te viteve te meparshme.

20.3 Ortaket ne cdo moment mund te vendosin krijimin e rezervave, si edhe masen e tyre.



**KREU VI
PRISHJA DHE NJOFTIMET**

**NENI 21
PRISHJA DHE LIKUIDIMII SHOQERISE**

21.1 Ne rastin e likuidimit te Shoqerise do te zbatohen dispozitat e parashikuara ne ligjin nr. 9901 date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" (te ndryshuar).

**NENI 22
NJOFTIMET**

22.1 Te gjitha njoftimet kerkesat ose komunikimet e tjera qe u jepen personave ose qe bejne personat sipas Statutit do te kryhen me shkrim ose permes komunikimit elektronik (nese ka) dhedo te konsiderohen te kryera ne menyre te rregullt kur u dergohen ne adresat e deklaruarat prej tyre prane Administratoreve te Shoqerise. Per kete qellim, brenda 5 (pese) diteve nga regjistrimiefektiv i cdo ortakut (si i tille) ne regjistrin tregtar, ky i fundit eshte i detyruar ti komunikojte administratorit adresen postare dhe adresen postare elektronike ku deshiron te marre njoftimet. Brenda te njejtit afat i komunikon administratorit te shoqerise adresen e re, kur adresa ndryshon, ne te kundert njoftim konsiderohet si i kryer rregullisht.

22.2 Njoftimet zyrtare te komunikimeve me ane te mjeteve elektronike vertetohen sipas Legjislacionit per nenshkrimin elektronik dhe dergohen ne adresat elektronike te deklaruarat prej tyre.

22.3 Ne rastin kur nje kuote zoterohet nga me shume se nje person te gjitha njoftimet do ti drejtohen perfaqesuesit te bashkezoteruesve te kuotes.

**KREU VII
DISPOZITA PER FUNDIMTARE**

**NENI 23
LIGJII ZBATUESHEM**

23.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Akt themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe me ligjin shqiptar. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Akt, do te zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar perkates ne fuqi.

23.2 Ky Akt hartohet ne 4 (kater) kopje origjinale ne gjuhen Shqipe, dhe pasi lexohet nga Ortaket themelues, firmoset si me poshte prej tyre

Ortaku i vetem Themelues

Enea MURATAJ

